Intenzivisht -> I zakonshëm -> ECO -> Qelqi -> 90 Min -> I shpejtë;

Kur përzgjedhni programin, do të ndriçojë llambëza përkatëse që e shënon këtë program. Pastaj shtypni butonin për start/pushim. Makina do të fillojë të funksionojë.

⚠ VENI RE:

Nëqoftëse shtypni butonin për start/pushim gjatë funksionimit të ciklit pastrues, llambëza sinjalizuese për rrjedhjen e pastrimit do të ndërprejë pulsimin, kurse makina për pastrimin e enëve do të bipojë çdo minutë, derisa përsëri nuk trusni butonin për start/pushim.

Ndryshimi i programit të përzgjedhur

Parakusht:

1. Ciklin e pastrimit në rrjedhje mund ta ndryshoni vetëm nëqoftëse ai rrjedh një kohë të shkurtër. Në rastin e kundërt, detergjenti është shtuar prej enëzës në brendësi të makinës, kurse uji mund të jetë dalë nga makina. Në këtë rast nevojitet që enëzën për detergjent sërish ta mbushni (shiqo kapitullin "Shtuarja e detergjentit").
2. Shtypni butonin për start/pushim. Aparati do të kalojë në gjendje të gatishmërisë. Shtypni butonin për përzgjedhjen e programit dhe e mbani së paku 3 sekonda. Pastaj mund të ndryshoni rregullimin e ciklit pastrues (shiqoni kapitullin "Nisja e ciklit pastrues").

⚠ VENI RE:

Nëqoftëse gjatë ciklit pastrues hapni derën e makinës për pastrimin e enëve, zbatimi i programit të pastrimit do të ndërprehet përkohësisht. Llambëza programore do të ndërprejë pulsimin dhe aparati do të bipojë çdo minutë, derisa nuk e mbyllni derën. Pasiqë e mbyllni derën e makinës për pastrimin e enëve, pas dhjetë sekondash aparati do të vazhdojë me funksionimin.

Nëqoftëse makina juaj përmban edhe funksionin e memorjes për rast të gabimit ose dështimit të energjisë elektrike, programi i përzgjedhur do të përfundojë edhe në rast të dështimit të furnizimit me energji elektrike.

Keni harruar të futni ndonjë copë ene?

Copën e harruar të enës mund të futni në makinë kurdo, para se të hapet enëza për detergjent.

- | | |
|--|---|
| 1 vetm pak e hapni derën, që cikli pastrues të ndërprehet. | 4 Mbyllni derën e makinës për pastrimin e enëve. |
| 2 pasi që dorezat spërkatëse ndërprejnë rrotullimin, derën mund të hapni deri në fund. | 5 Pas dhjetë sekondash, makina për pastrimin e enëve do të vazhdojë me ciklin pastrues. |
| 3 Futni enën e harruar. | |

Paspërfundimit të programit

Pas përfundimit të ciklit pastrues, makina do të bipojë tetë herë. Shkyçni makinën me butonin për kyçje/shkyçje. Mbyllni ventilin e ujit dhe hapni derën e makinës për pastrimin e enëve. Paraprakisht se të filloni të zbrazni makinën pas përfundimit të ciklit, pritni përafërsisht 15 minuta. Kështu ena do të ftohet deri diku; kur është ena e nxehtë, ajo është më e ndjeshme dhe e thyeshme. Kështu ena edhe do të teret më mirë.

Shkyçja e aparatit

Llambëza sinjalizuese e cila shënon programin e përzgjedhur ndriçon, por nuk pulson. Në këtë rast programi ka përfunduar.

1. Shkyçni makinën për pastrimin e enëve me shtypjen e butonit kyçje/shkyçje.
2. Mbyllni rubinetën e ujit.

Me kujdes hapni derën e makinës.

Enët e nxehta janë të ndjeshme dhe më shpejtë plasin, prandaj nevojitet ta leni përafërsisht 15 minuta që të ftohet, para se ta nxjerrni nga makina.

Hapni derën e makinës për pastrimin e enëve dhe leni disa minuta të gjysëmhapur, paraprakisht se të nxjerrni enët. Kështu enët do të jenë më pak të nxehta, por edhe terja do të jetë më efikase.

Nxjerrja e enëve nga makina

Është e zakonshme që në anën e brendëshme makina është pak e lagshtë.


Së pari zbrazni shportën e poshtme, pastaj edhe të epërmen. Kështu do të parandaloni që mbeturinat eventuale të ujit të mos pikojnë nga sendet në shportën e epërme nëpër enët në shportën e poshtme.

⚠ PARALAJMËRIM! Hapja e derës së makinës për pastrimin e enëve gjatë ciklit pastrues është e rrezikshme, sepse uji i nxehtë nga makina mund të ju djeg.

7. Mirëmbajtja dhe pastrimi

Sistemi filtrues

Filtri parandalon që mbeturinat e mëdha të ushqimit ose sendet tjera të hyjnë në pompën e makinës. Mbeturinat mund të shtupojnë filtrin. Në këtë rast nevojitet të evitohen mbeturinat.



Sistemin filtrues e përbajnë filtri i vrazhdët, filtri kryesor (i rrafshë) dhe filtri i dendur (mikro filtri).

Filtri kryesor (1)

Fiskaja e posaçme nga doreza e poshtme spërkatëse shkatërron ushqimin dhe pjesët e ndyrësirave, të cilat tubohen në këtë filtër dhe i spastron në tubacion.

Filtri i vrazhdët (2)

Copat e mëdha, për shembull copëzat e kockave ose të qelqit të cilët mund të shtupojnë tubacionin, tubohen në filtrin e vrazhdët. Për të evituar sendet e tubuara në filtër, me kujdes shtypni mbajtësen në maje të filtrit dhe e çoni.

Filtri i dendur (3)

Filtri në fjalë mban ndyrësit dhe mbeturinat e ushqimit në fundin e makinës, në zonën e tubacionit dhe parandalon që përsëri të mbesin në enë.

Kompleti filtrues


Filtri me efikasitet eviton grimcat e ushqimit nga uji, me të cilin shpërlahet ena dhe kështu mundëson përdorimin e shumë hershëm të ujit. Për rezultate më të mira nevojitet rregullisht të pastrohet filtri. Prandaj është e preferueshme që pas çdo cikli pastrues të evitoni grimcat e mëdha të ushqimit, të cilat janë të tubuara në filtër pas çdo cikli pastrues, ashtu që të shpërlani filtrin gjysëmrrreth dhe boshtin nën ujë të rrjedhshëm. Mbaresën filtruese e evitoni ashtu që e çoni mbajtësen e boshtit filtrues.



PARALAJMËRIM!

Mos përdorni makinën për pastrimin e enëve, nëqoftëse nuk është filtri i instaluar.

Filtri i instaluar në mënyrë jo të rregullt mund të ul efikasitetin e aparatit dhe të dëmtojë enët dhe pajisjet e hajes.



Hapi i 1.: rrotulloni filtrin në anën e kundërt të akrepit të orës.

Hapi i 2.: çoni kompletin filtrues.



VENI RE: me këtë rradhitje të hapav do të evitoni filtrin. Shkoni me hapat e njejta në rradhitjen e kundërt, që përsëri të instaloni filtrin.

Veni re:

Pas çdo përdorimi të makinës, kontrolloni se ndoshta mos janë të shtupuar filtrat.

Kur e zhvendosni filtrin e vrazhdët, mund të evitoni sistemin filtrues. Evitoni mbeturinat e ushqimit dhe pastroni filtrin nën ujë të rrjedhshëm.

⚠ VENI RE: Tërë kompletin filtrues pastroni njëherë në javë.

Pastrimi i filtrit

Filtrin e vrazhdët dhe ate të dendur pastroni me fuqë. Përsëri montoni pjesët e filtrit siç shihet në fotosat në faqen paraprahe dhe përsëri instaloni tërë kompletin filtrues në makinën për pastrimin e enëve dhe e përforconi me trusjen poshtas.

⚠ PARALAJMËRIM

Mos troketni filtrat që t'i pastroni. Me këtë mund të ndryshoni formën e filtrit, e kjo dobëson efikasitetin e makinës për pastrimin e enëve.


Kujdesi për makinën për pastrimin e enëve

Panelin për mbikqyrje mund të pastroni me leckë të lagështuar lehtë. Pas pastrimi të panelit për mbikqyrje, ate e terni me përpikshmëri.

Për pastrimin e jashtësisë së makinës përdorni dyll të mirë për trajtimin e aparateve.

Kurrë mos përdorni sende të mprehta për pastrim, spuzhva prej teli ose lëndë pastruese abrazive, pa marrë parasysh se për cilën pjesë të makinës bëhet fjalë.

Pastrimi i derës



Për pastrimin e skajeve rreth derës përdorni vetëm leckë të butë dhe të lagshtë. Për të parandaluar depërtimin e ujit në bravë, resp. në mekanizmin për mbyllje dhe te komponentat elektrike mos përdorni lëndë pastruese në formë të spërkatësve.

⚠ PARALAJMËRIM!

Kurrë mos pastroni pllakën e derës me lëndë pastruese në formë të spërkatësve, sepse kjo mund të dëmtojë bravën dhe komponentet elektrike.

Mos përdorni lëndë pastruese të vrazhdëta dhe disa lloje të peshqireve nga letra, ata mund të gërvishin makinën ose të lënë gjurma në sipërfaqen nga çeliku jokorodues.

Mbrojtja nga ngrirja

Ju lutemi që gjatë dimrit të kujdeseni që asnjë pjesë e makinës për pastrimin e enëve të mos mbetet nën ndikimin e ngrirjes. Pas çdo cikli pastrues, merrni në përfillje udhëzimet në vijim:

1. Shkyçni aparatën nga rrjeta elektrike.
2. Mbyllni furnizimin me ujë dhe nxjerrni (shkyçni) gypin nga rubineti, resp. ventilin për ujë.
3. Zbrazni ujin nga gypin furnizues dhe nga rubineta (në çfarëdo ene për tubimin e ujit).
4. Përsëri kyçni gypin furnizues në ventil, resp në ujësjellës.
5. Evitoni filtrin në fundin e banjos (brendësisë) së makinës për pastrimin e enëve dhe evitoni ujin me spuzhvë thithëse.

⚠ VENI RE: Nëqoftëse makina juaj për pastrimin e enëve nuk funksionon për shkak se njëri nga pjesët e saj ka ngrirë, thirrni serviserin.


Pastrimi i dorezave spërkatëse

Dorezat spërkatëse nevojitet të pastrohen rregullisht, që të parandaloni ate që mbeturinat nga uji i fortë (guri gëlqeror) të mos shtupojë shobat dhe kështu të vështirësojë kushinetat.

Dorezën e epërme spërkatëse e evitoni ashtu, që mbani dadonë dhe rrotulloni dorezën spërkatëse në drejtim të akrepit të orës.

Dorezën e poshtme spërkatëse e evitoni ashtu që ate e tërheqni naltas.

Dorezat spërkatëse i pastroni me shumë sapuni dhe në ujë të ngrohtë dhe leckë të butë i pastroni shobat. Pasiqë i pastroni me përpikshmëri, sërish vëndoni në vende të veta.



Ruajtja e makinës për pastrimin e enëve në gjendje të mirë

Pas çdo pastrimi

Pas çdo cikli pastrues, mbyllni furnizimin me ujë në aparat dhe leni derën gjysëm të hapur, që lagështia dhe duhmat të mos mbesin të mbyllura në makinë.

Tërhiqni spinën

Para pastrimit ose veprimeve mirëmbajtëse gjithmonë nxjerrni spinën nga priza.

Mos përdorni hollues (tretësira) ose lëndë pastruese abrazive

Për pastrim të jashtësisë së aparatit dhe pjesëve të tij nga goma kurrë mos përdorni hollues (tretësira) ose lëndë pastruese të vrazhdëta resp. abrazive. Përdorni vetëm leckë me shumë të ngrohtë. Nëqoftëse dëshironi të evitoni njollat ose vijat nga sipërfaqja e brendshme e aparatit, përdorni leckën e lagështuar me ujë, të cilës i keni shtuar ca uthull të verës, ose lëndë pastruese të dedikuar për pastrimin e makinave për pastrimin e enëve.

Kur nuk e përdorni makinën gjatë kohë

Rekomandojmë që ciklin pastrues ta nisni me makinën e zbrazët për pastrimin e enëve. Tërheqni spinën nga priza, mbyllni furnizimin me ujë dhe leni derën e aparatit gjysëm të mbyllur. Kështu do të zgjatni jetën e guarnicioneve në derë dhe do të parandaloni shkaktimin e duhmave të padëshirueshme në aparat.

Lëvizja e aparatit

Nëqoftëse nevojitet të lëvizni aparatit, provoni të zbatoni këtë ashtu, që aparati të mbetet tërë kohën në pozicion vertikal. Nëqoftëse është e pashmangshme, atë mund ta ktheni në faqen shpinore.

Guarnicionet

Njëri nga faktorët, resp. shkaqet për duhmat e padëshirueshme në makinën për pastrimin e enëve janë mbeturinat në guarnicione. Evitoni këto mbeturina me leckë të lagshtë, që të parandaloni këto duhma të padëshirueshme.

8. Udhëzime për pozicionim

▲ KUJDES!

Aderimi në rrjetën e ujësllësit dhe elektrike mund të zbatohet vetëm nga profesionisti i aftësuar.

Paraljmërim!

- RREZIK I GODITJES ELEKTRIKE!
- PARA FILLIMIT TË POZICIONIMIT, SHKYÇNI APARATIN NGA RRJETA ELEKTRIKE.
- NËQOFTËSE NUK VEPRONI KËSHTU, JENI TË EKSPOZUAR RREZIKUT TË GODITJES ELEKTRIKE DHE RREZIKUT NGA VDEKJA.

Përgatitja për pozicionimin e aparatit

Poziciononi aparatit në vendin e përzgjedhur në afërsi të ujësllësit ekzistues dhe shkarkimit të ujit (tubacion) dhe prizaës përkatëse për aderim në rrjetën elektrike.

Për kyçjen më të lehtë të gypit shkarkues të aparatit në tubacion, makinën për pastrimin e enëve vëndoni pranë elementit kuzhinor me govatën për pastrim.

Paraljmërim: kontrolloni pajimet e bashkangjitura për pozicionim (konsola për qeshërën dekorative, vidhën për përforcim).

Saktësisht mësoni udhëzimet për pozicionim:

- Ilustrimet me dimensionet e elementeve kuzhinore dhe pozicionin për pozicionimin e makinës për pastrimin e enëve
1. Për kyçjen e lehtë të gypit shkarkues të aparatit në tubacion, makinën për pastrimin e enëve vëndoni pranë elementit kuzhinor me govatën për pastrim (shiqo fotosin 1).
 2. Nëqoftëse keni ndërmend të vëndoni makinën për pastrimin e enëve në afërsi të elementit skajor, merrni në konsiderim mjaft hapësirë për hapjen e lirë të derës (shiqo fotosin 2).



(Fotosi 1):

Dimensionet e hapësirës në elementet kuzhinore Së paku 5 mm ndërmjet të sipërfaqes së sipërme të makinës për pastrimin e enëve dhe pultosë për punë si dhe sipërfaqet anësore të jenë të rreshtuara me elementin.

(hapësira për kyçje në rrymë, furnizim dhe shkarkim të ujit; diferenca ndërmjet të fundit të elementit dhe dyshemesë)

(Fotosi 2):

Largësia më e vogël e nevojshme për hapjen e derës.
(makina për pastrimin e enëve – elementi kuzhinor – dera e makinës – largësia më e vogël 50 mm)




● Përmasat dhe instalimi i panelit dekorativ

1. Panelin dekorativ nga druri mund të përpunoni siç shihet në fotosin 3.

[Fotosi 3]


Panelin dekorativ nevojitet
përpunoni siç e
shfaqin përmasat e vizatuara
(Njësia: mm)



2. Shiritin ngjitës A dhe shiritin ngjitës B shngjitni, shiritin ngjitës A e ngjitni në panelin dekorativ nga druri dhe shiritin ngjitës B në derën e makinës për larjen e rrobave (shiqoni fotosin 4a). Kur e vendoni panelin, me vidha e vidhoni në derë (shiqoni fotosin 4b)

[Fotosi 4a]

Instalimi i panelit dekorativ




[Fotosi 4b]

Instalimi i panelit dekorativ nga druri

1. Hiqni katër vidhat e shkurtëra

2. Vidhoni katër vidhat e gjata



● Rregullimi i fleksibilitetit të sustës së derës


Fleksibiliteti i sustës së derës mund të jetë fabrikisht i rregulluar ashtu që i përputhet derës. Nëqoftëse e instaloni panelin dekorativ, do të nevojitet të përshtatni edhe fleksibilitetin e sustës së derës.

Rrotulloni vidhën rregulluese, që të rrotulloni rregullatorin dhe kështu të tendosni ose shtendosni kabllonë nga çeliku (shiqoni fotosin 5).

Susta e derës është e tendosur në rregull, kur dera e hapur deri në fund mbetet në pozicion horizontal, e çohet dhe gati se mbyllet nëqoftëse e shtyni vetëm pak me gisht.


[Fotosi 5]

Rregullimi i fleksibilitetit të sustës së derës



Kyçja e gypit shkarkues

Instaloni gypin shkarkues në hapësirën me diametër së paku 40 mm, ose e instaloni në govatë, këtu jeni të kujdesshëm që gypi të mos jetë askund i palosur ose shtypur. Maja e gypit shkarkues nuk guxon të jetë më shumë se 1.000 mm mbi dyshtemenë, në të cilën është pozicionuar makina.



Procesi i instalimit të makinës për pastrimin e enëve në rreshtin e elementeve kuzhinore

1. Gypin për furnizim me ujë përforconi në rubinetë me ujë të ftohtë.
2. Aderoni gypin për shkarkimin e ujit nga makina. Veproni në përputhje me vizatimin (fotosi 3).
3. Aderoni kabllonë kyçëse në rrjetën elektrike.
4. Nën sipërfaqen e pultosë për punë ngjitni shiritin e kondensit. Te ngjtija jeni të kujdesshëm që shiriti të jetë i rrafshuar me skajin e sipërfaqes për punë të pultosë (vizatimi nr. 1).
5. Futni aparatit në hapësirën e paraparë dhe poziciononi me rregull (vizatim nr. 2).
6. Barazpeshoni aparatit. Këmbëzat e pasme mund të rregullohen nga ana e parë e aparatit, me rrotullimin e vidhës me ndihmën e çelësit ngulës (imbus) në mes të pjesës së përfundëshme të parë të aparatit (vizatimi nr. 3a). Këmbëzat e përparme mund të barazoni me rrotullimin e dadove rregulluese me ndihmën e kaçavidhës së rrafshë (vizatimi nr. 3b).
7. Pasiqë makina për pastrimin e enëve vëndohet në pozicion vetëqëndrues, ate nevojitet të përforconi. Këtë mund të veproni në dy mënyra:
 - A. Pultoja normale për punë: profilin montues skajor në të majtën (ose djathtë) futni në hapësirën e paraparë në sipërfaqen anëshe të majtë (djathtë) dhe e përforconi në pultonë e punës me ndihmën e dy vidhave për dru (vizatimi nr. 4).
 - B. Pultoja e punës nga mermeri ose graniti: lakoni profilin montues skajor në anën e majtë (djathtë) nën këndin e drejtë dhe futni në hapësirën e paraparë në sipërfaqen anëshe të majtë (djathtë) dhe e përforconi në pultonë e punës me ndihmën e dy vidhave për dru (vizatimi nr. 5).
8. Lakoni konsolat montuese të panelit dekorativ të poshtëm të elementit kuzhinor në thellësi përkatëse (vizatimi nr. 6) dhe i përforconi në qeshërën dekorative (vizatimi nr. 7).
9. Me ndihmën e konsolave përforconi qeshërën dekorative të elementit kuzhinor në bazamentin e makinës për pastrimin e enëve (vizatimi nr. 8).




Figure 7

Për funksionimin e rregullt të dorezave spërkatëse dhe për funksionimin e programit të pastrimit, është e rëndësishme që makina për pastrimin e enëve të jetë barazpeshuar mirë dhe të jetë në pozicion horizontal.


1. Barazpeshimin e makinës për pastrimin e enëve e kontrolloni ashtu, që peshoren e ujit e vëndoni së pari në rrafshas në derë, pastaj edhe për së gjati në skajin anësh të udhëzuesit në komorën e brendëshme të aparatit, siç shihet në vizatim
2. Barazpeshoni makinën për pastrimin e enëve me rrotullimin, resp. me rregullimin e çdo këmbëze rregulluese veças.
3. Kujdeseni që të mos ndodh, që makina për pastrimin e enëve gjatë procesit të barazpeshimit padashtë të përmbysset.

(fotosi 5):

Vizatimi me këmbëzat e rregullueshme

VENI RE:

Distanca më e madhe e lartësisë së rregullimit të këmbëzave është 50 mm.



Aderimi në rrjetën elektrike

⚠ PARALAJMËRIM!

Për sigurinë tuaj personale:

PËR FURNIZIMIN E APARATIT NË FJALË ME ENERGJI ELEKTRIKE MOS PËRDORNI VAZHDUES, NDARËS OSE SHNDËRRUES (KONVERTERË).

KURRË DHE NËN ASNJË LLOJ RRETHANASH MOS PRENI OSE EVITONI PËRÇUESIN TOKËZUES NGA KABLOJA FURNIZUESE.

Kërkesat sa i takon energjisë elektrike

Ju lutemi që të kontrolloni tensionin elementar në panelin e shënimeve të aparatit dhe aderoni makinën për pastrimin e enëve në burim përkatës me energji elektrike (rrjetën elektrike). Përdorni siguresë të paraparë 10-amperëshe. Rekomandohet përdorimi i siguresës me lëvizje kohore ose mbaresën për ndërprerje të rrymës elektrike (siguresë automatike). Për makinën për pastrimin e enëve kujdeseni të ketë veças, qark të ndarë.

⚠ para përdorimit
kontrolloni se a është aparati i
tokëzuar në rregull

Aderimi në rrjetën elektrike

Binduni që tensioni dhe frekuenca në rrjetën elektrike janë në përputhje me të dhënat në panelin e shënimeve. Spinën kyçni vetëm në prizë të përshtatshme dhe të tokëzuar. Nëqoftëse priza elektrike në të cilën keni ndërmend të kyçni aparatit, nuk është e përshtatshme për spinën e vënduar, ndërroni prizën dhe mos përdorni shndërrues, sepse ata



UDHËZIME PËR TOKËZIM

■ mbaresa nevojitet të tokëzohet. Në rast të gabimit të funksionimi ose prishja, ajo ul mundësinë e goditjes elektrike, sepse kujdeset për rrugën e rezistencës më të vogël për rrymën elektrike. Aparati është i pajisur me kablo kyçëse me përçues tokëzues dhe spinë të tokëzuar. Spinën kyçni në prizë përkatëse, e cila është e instaluar dhe e tokëzuar në përputhje me standardet dhe kërkesat lokale në fuqi.

⚠ PARALAJMËRIM!


Tokëzimi jo i rregullt i aparatit mund të shkaktojë rrezikun e goditjes elektrike!

Nëqoftëse dyshoni, lejoni profesionistin përkatës për instalime elektrike të kontrollojë rregullsinë e tokëzimit të aparatit.

Mos ndryshoni spinën, të instaluar në kabllonë kyçëse të aparatit. Nëqoftëse spina nuk puthitet mirë me prizën, profesionisti i aftësuar për instalime elektrike le të instalojë prizë përkatëse.

Aderimi në rrjetën e ujësjellësit

Kyçja e gypit mbrojtës për furnizimin me ujë



Aparatin nevojitet të kyçni në ujësjellës me kompletin e rinj të gypave. Mos përdorni complete gypash të vjetër.

Shtypja e ujit nevojitet të jetë ndërmjet të 0,04 MPa dhe 1 MPa. Nëqoftëse është shtypja nën vlerën minimale, këshillohuni me kompaninë e ujësjellësit.

Krejtësisht tërheqni gypin mbrojtës furnizues nga sirtari për ruajtje, i cili gjendet në anën shpinore të makinës për pastrimin e enëve.

Përforconi vidhat në gypin mbrojtës furnizues në rubinetën me 3/4 – col vidhë. Para se të nisni makinën për pastrimin e enëve, krejtësisht hapni rubinetën e ujit.

PËR GYPIN MBROJTËS FURNIZUES TË UJIT

Gypi mbrojtës furnizues për ujin përmban muri të dyfishtë. Sistemi i gypave parandalon lëshimin edhe në rastet kur plas gypi, sepse në këtë rast uji rrjedh në hapësirën ndërmjet të gypit furnizues dhe mbështjellësin e jashtëm të rrudhur.

PARALAJMËRIM!

Gypi, të cilin e lidhni me rubinetën mbi lavaman në kuzhinë mund të plas, nëqoftëse është e kyçur në linjën e njejtë të ujësllësit sikur makina për pastrimin e enëve. Nëqoftëse në lavamanin tuaj keni llojin e tillë të gypit, rekomandojmë që ta shkyçni dhe shtuponi hapësirën.

Shkyçja e gypit mbrojtës për furnizim me ujë

1. Mbyllni furnizimin me ujë.
2. Lironi shtypjen e ujit me trusjen e pullës për lirim të shtypjes. Kështu do të lironi shtypjen dhe do të mbron veten dhe pajimet në hapësirën para spërkatjes së fuqishme
3. Zhvendosni mbarsën e gypit mbrojtës nga rubineta.

KYÇJA PËR UJIN E FTOHTË

Kyçni gypin furnizues për ujin e ftohtë në rubinetë (3/4 col) dhe binduni që gypi është i përforcuar mirë. Nëqoftëse gypi furnizues për ujë është i rinj ose nëqoftëse gjatë kohë nuk e keni përdorur, lëshoni nëpër të ujin e rrjedhshëm, që të bindeni që uji rrjedh i pastër dhe pa ndyrësira. Nëqoftëse nuk veproni kështu, gypi furnizues për ujë mund të shtupohet, e kjo mund të dëmtojë aparatit.

 **PARALAJMËRIM!** Ju lutemi që pas përdorimit të makinës për pastrimin e enëve të mbyllni rubinetën, resp. ventilin e ujit.

Vënduarja e aparatit

Makinën për pastrimin e enëve vendosni në lokacionin e dëshiruar. Ana shpinore e aparatit le të mbështetet në murin pas tij, kurse sipërfaqet anëshe le të jenë të barazuara me anët e elementeve kuzhinore. Makina për pastrimin e enëve është e pajisur me gypat për furnizim dhe shkarkim të ujit, të cilët për shkak të montimit më të lehtë mund të instalohen në secilën anë të aparatit.

Si të lëshojmë ujin e tepërt nga gypat

Nëqoftëse lavamani është mbi 1.000 mm mbi dyshemenë, në të cilën është e pozicionuar makina për pastrimin e enëve, ujin e tepërt nuk mund të lëshojmë nga ajo. Në këtë rast shteroni ujin e tepërt prej gypave në enën përkatëse, të cilën e mbani më ulët se niveli i lavamanit.

Gypi shkarkues për ujin

Kyçni gypin shkarkues për ujin. Gypin shkarkues nevojitet të përforconi mirë, që të parandaloni daljen e ujit. Kujdeseni që gypi shkarkues askund të mos jetë i palosur ose i shtypur.

Vazhduesi i gypit shkarkues

Nëqoftëse nevojitet të përdorni vazhdues për gypin shkarkues, përdorni gypin që është i ngjajshëm me atë që i është bashkangjitur aparatit.

Gypi nuk guxon të jetë më i gjatë se katër metra. Në rastin e kundërt, efikasiteti i makinsë për pastrimin e enëve do të jetë më i vogël.

Kyçja në sifon

Kyçja për shkarkimin e ujit nga makina për pastrimin e enëve nevojitet të jetë së paku 1.000 mm mbi nivelin e fundit të makinës për pastrimin e enëve. Gypin shkarkues për ujin nevojitet ta përforconi.

Nisja e makinës për pastrimin e enëve

Para se të nisni makinën për pastrimin e enëve, kontrolloni këto:

- a është makina për pastrimin e enëve e barazpeshuar dhe përkatësisht e përforcuar?
 - a është e hapur rubineta e ujit?
 - a lëshojnë gypat ujin?
 - a është kablloja kyçëse fortë në prizë?
 - a është aparati i kyçur?
 - a janë gypi furnizues dhe ai shkarkues për ujë të ngatërruar, të palosur ose të shtypur?
- Evitoni tërë ambalazhin dhe letrat e shtypura nga makina për pastrimin e enëve.

 **Kujdes:** Pas vënduarjes, ruani këtë doracak. Përmbajtja e doracakut mund të jetë në ndihmë të madhe përdorësve të tij.

9. Këshilla për evitimin e vështirësive

Para se të thirrni serviserin

Me këshillat në tabelë në faqet vijuese keni mundësi që disa nga vështirësitë t'i evitoni vetë, pa ndihmën e serviserit.



Vështirësitë
teknike

<i>Vështirësia</i>	<i>Shkaqet e mundëshme</i>	<i>Si të veprohet</i>
Nuk mund të nis makina për pastrimin e enëve.	Siguresa e djegur ose kurdisur siguresa automatike	Ndërroni siguresën ose ose rirregulloni siguresën automatike. Evitoni aparatet tjera eventuale, me të cilët makina ndan furnizuesin përçues.
	Aparati nuk është i kyçur.	Kontrolloni a është aparati i kyçur dhe a është dera e mbyllur mirë. Binduni që kabloja kyçëse është mirë e futur në prizë.
	Shtypja e ujit është e ulët.	Kontrolloni se a është i kyçur në rregull gypi furnizues i ujit dhe se a është e hapur rubineta e ujit.
	Dera e makinës nuk është e mbyllur mirë.	Kujdeseni që dera të mbyllet mirë.
Uji mbetet në makinën për pastrimin e enëve.	Gypi shkarkues i palosur ose i shtypur.	Kontrolloni gypin shkarkues.
	Filtrat janë të shtupuar.	Kontrolloni filtrin e vrazhdët (shiqo kapitullin "Pastrimi i filtrit").
	Govata për pastrim është e shtupuar.	Kontrolloni govatën për pastrim dhe binduni që tubacioni funksionon mirë. Nëqoftëse është gabimi te tubacioni i govatës për pastrim dhe jo gypit shkarkues, ndoshta do të ju nevojitet ndihma e mjeshtrit të ujësjellësit dhe jo të serviserit për makinat e pastrimit të enëve.
Shkuma ose shkuma e sapunit në kazan (në brendësi) të makinës për pastrimin e enëve	Detergjenti jo i përshtatshëm	Përdorni vetëm detergjente të posaçme për makinat për pastrimin e enëve, që të parandaloni shkumimin tejet të madh. Nëqoftëse vjen deri te kjo, çelni makinën për pastrimin e enëve dhe pritni që shkuma të tretet. Në kazan të makinës futni katër litra ujë. Mbyllni derën e makinës për pastrimin e enëve dhe përzgjedhni cilindo cikël. Makina do të popmojë ujin nga kazan. Pasi përfundon pompimi i ujit, hapni derën e makinës dhe kontrolloni se a është zhdukur shkuma. Sipas nevojës, përsëritni procesin.
	E derdhur lënda për shpërlarje	Gjithmonë menjëherë të fshini lëndën pastruese të derdhët.
	Keni përdorur detergjent me ngjyrë.	Binduni që përdorni detergjent pa ngjyrë.
Vështirësi të përgjithshme	Njolla në brendësi të makinës për pastrimin e enëve	Binduni që përdorni detergjent pa ngjyrë.
	Shtresa e bardhë në sipërfaqen e brendëshme	Për pastrimin e brendësisë së makinës për pastrimin e enëve përdorni spuzhven e lagshtë dhe detergjent për makinën për pastrimin e enëve, patjetër mbani të veshura dorëza mbrojtëse nga goma. Kurrë mos përdorni ansjë lëndë pastruese tjetër përveç të detergjentit për makinat për pastrimin e enëve, përndryshe mund të shkactohtet shumë.
	Në kompletin e hajes janë njolla ndryshku.	Kompleti i hajes nuk është rezistues në korodim. Te shtuarja e krypës nuk keni nisur menjëherë ciklin pa enë në makinë dhe pa funksionin e funksionimit intensiv pastrues. Gjurmata e krypës kanë mbetur në ujin për ciklin pastrues. Kapaku i mbaresës për zbutjen e ujit nuk është mirë i vidhurar.
Zhurma	Zëri i trokitjes në brendësi të makinës gjatë funksionimit.	Ndërpreni programin e pastrimit dhe rirradhitni pajimet që pengojnë rrotullimin e dorezës spërkatëse.
	Rrapëllima në brendësi të makinës gjatë funksionimit.	Ndërpreni programin dhe rirradhitni enët.

Zëri i trokitjes në gypin furnizues ose shkarkues	Kjo mund të jetë pasojë e instalimit ose dimensionit të pjesës së gypit.	Kjo nuk ndikon në funksionimin e makinës për pastrimin e enëve. Nëqoftëse dyshoni, thirrni serviserin.
---	--	--

 Rezultatet e pakënaqshme të pastrimit	Vështirësia	Shkaqet e mundëshme	Si të veprohet
	Ena nuk është e pastër	Ena nuk është mirë e rradhitur. Programi i përzgjedhur nuk ka qenë mjaft i fortë. Pak detergjent është shtuar. Sendet në makinë pengojnë rrotullimin e dorezave spërkatëse. Kompleti filtrues në fundin e makinës për pastrimin e enëve nuk është i pastër ose nuk është mirë i venduar. Kjo mund të shkaktojë bllokimin e dorezave spërkatëse.	Shiqoni vërejtjet nën "Rradhitja e enëve në makinën për pastrimin e enëve". Përzgjedhni program më intensiv. Shiqo "Tabela e programeve të pastrimit". Përdorni më shumë detergjent ose tjetër detergjent. Rirradhitni sendet, që dorezat spërkatëse të rrotullohen lirisht. Pastroni dhe/ose instaloni kompletin filtrues. Pastroni shobat në dorezat spërkatëse. Shiqoni kapitullin "Pastrimi i dorezave spërkatëse".
	Qelqi i turbullt	Kombinacioni i ujit të fortë dhe sasi të mëdha të detergjentit.	Përdorni më pak detergjent. Nëqoftëse uji në ujësjellësin tuaj është i butë, për pastrimin e qelqit përdorni program më të shkurtër.
	Vijat e zeza ose të hirta në enë.	Pajimet nga alumini janë fërkuar me enët.	Me lëndë pastruese të lehtë abrazive evitoni vijat nga enët.
	Detergjenti mbetet në enën dozuese.	Ena pengon kapakun e enës dozuese.	Rirradhitni sërish enët.
	Enët nuk janë të thata.	Rradhitja jo e përshtatshme në makinë Pak lëndë shpërlarëse	Rradhitni enët në makinë në përputhje me udhëzimet. Rritni sasinë e lëndës shpërlarëse dhe atë shtoni në mbaresën dozuese për të.
	Rezultatet jo të kënaqshme të terjes	Keni nxjerrë enët para kohe nga makina për pastrimin e enëve.	Mos zbrazi makinën për pastrimin e enëve menjëherë pas përfundimit të ciklit pastrues. Hapni lehtë derën, që të del avulli nga brendësia nga makina. Enët filloni t'i nxjerrni nga makina pasi që ato janë pak të ngrohta. Së pari zbrazi shportën e poshtme. Kështu do të parandaloni që uji të pikojë mbi enët në shportën e poshtme.
		Keni përzgjedhur programin e gabimshëm.	Te programi i shkurtër, temperatura e pastrimit është më e ulët. Kjo ul efikasitetin e pastrimit. Përzgjedhni programin me kohën e gjatë të pastrimit.
		Përdorni pajimet me shtresën e jashtme jociësore.	Te pajimet në fjalë, heqja e ujit është më e vështirë. Pajimet dhe enët e tilla nuk janë të përshtatshme për pastrim në makinën për pastrimin e enëve.

Kodet e gabimeve

Në rastin e disa gabimeve, makina për pastrimin e enëve do të tregojë kodin e gabimit.


Kodet	Interpretimet	Shkaqet e mundshme
Drita e Opcionit "I Shpejtë" pulson	Kohë më e gjatë për furnizimin e lavastoviljes	Rubinetat nuk janë hapur ose furnizimi me ujë është i kufizuar, ose presioni i ujit është shumë i ulët
Drita e Opcionit "Qelqe" pulson	Mbi-furnizim me ujë	Disa elementë të lavastoviljes pikojnë/rrjedhin ujë.



PARALAJMËRIM!


Nëqoftëse vjen deri te derdhja e ujit, mbyllni ventilin kryesor për ujin dhe thirrni serviserin.

Nëqoftëse në fundin e kazanit të makinës për pastrimin e enëve gjendet uji, i cili ka mbetur nga derdhja ose lëshimit të vogël të ujit, nevojitet që para nisjes së sërishme të makinës për pastrimin e enëve të evitohet uji në fjalë.



Rradhitja e enëve në përputhje me EN50242:

1. Shporta e epërme:



Pjatat e vogla



Gotat




Tasi i vogël për servim



Tasi mesatar për servim



2 Shporta e poshtme:



Pjata për ëmbëlsira




Pjatat (të cekëta) për gjellën kryesore



Tabakjoja ovale

3. Shporta me pajisje:




1 lugë për supë



5 lugë për desert



2 piruni



6 lugë për servim



3 thika



7 piruna për servim



4 lugë çaji



8 lugë për salcë



Informatat për testin krahasues janë të shënuara në përputhje me standardin N 50242.

Kapaciteta: 12 komplete

Pozicioni i shportës së epërme: pozicioni i poshtëm

Programi: EKO (i pranueshëm për ambientin)

Sasia e lëndës së shtuar për shpërlarje: 6

Rregullimi i mbaresës për zbutje: H4

Tabela e të dhënave teknike

Tabela e të dhënave për makinën për pastrimin e enëve në amvisëri në përputhje me Direktivën e EU 1059/2010:

Prodhuesi	GORENJE
Tipi/Përshkrimi	GI61010X
Numri standard i kompleteve	12
Klasa e efikasitetit energjik (1)	A++
Harxhimi vjetor i energjisë (2)	258 kWh
Harxhimi i energjisë te programi standard i pastrimit	0,91 kWh
Harxhimi i energjisë në gjendjen e shkyçur	0,45 W
Harxhimi i energjisë në gjendjen e gatishmërisë	0,49 W
Harxhimi vjetor i ujit (3)	3080 litra
Klasa e efikasitetit tërës (4)	A
Programi standard i pastrimit (5)	ECO 45°C
Kohëzgjatja e programit standard të pastrimit	185 min
Niveli i zhurmës	49 dB (A) re 1 pW
Montimi (pozicionimi)	Instalimi nën pultinë e punës
Instalimi	PO
Lartësia	81,5 cm
Gjerësia	59,8 cm
Thellësia (me kyçësit)	57 cm
Harxhimi i energjisë elektrike	1930 W
Tensioni elementar / frekuenca	220-240 V-50 Hz
Shtypja e ujit (shtypja në instalim)	0,4 – 10 bar = 0,04 – 1 MPa

VENI RE:

1. A+++ (më efikas) deri D (efikasiteti më i ulët)
2. Në bazë të 258 cikleve standarde të pastrimit me kyçësin në ujë të ftohtë dhe harxhimin në mënyrën e kursimit me energjinë. Harxhimi faktik i energjisë varet nga përdorimi i makinës.
3. Shpenzimi i ujit 3080 litra është llogaritur në bazë të 280 cikleve standarde të pastrimit. Harxhimi faktik i ujit varet nga përdorimi i makinës.
4. Në rradhitjen prej G (efikasiteti më i ulët) deri A (më efikas).
5. Programi pastrues është program standard, i përdorur te llogaritja e të dhënave për rradhitje energjetike. Është i dedikuar për pastrimin e enëve të ndyra rëndomtë dhe sa i takon kombinimit të harxhimit të energjisë dhe ujit është program më efikas për këtë lloj enësh.

Në kohën e blerjes, aparati është i përshtatshëm ndaj standardeve europiane në fuqi dhe direktivave siç vijon:

- LVD 2006/95/EC
- EMC2004/108/EC
- ErP 2009/125/EC

Vlerësimet e larta janë të matura në bazë të standardeve nën kushtet e cekura të funksionimit. Rezultatet mund shumë të ndryshojnë sa i takon sasisë dhe shkallës së ndyrësisë së enëve, fortësisë së ujit, sasisë së detergjentit të dozuar dhe të ngj.

Doracaku është i bërë në përputhje me standardet dhe rregullat e Unionit Europian.